



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 464 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 90, datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike për segmentin shtesë të projektit "*Linja e Optimizimit të Ujësllësit, Durrës*"- subjekti A.K.U.K. në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD STAR" sh.p.k. dhe projektin për segmente të tjera shtesë,

VENDOSI:

1. Të miratohet Konceptin e sondazheve arkeologjike për segmentin shtesë të projektit "*Linja e Optimizimit të Ujësllësit, Durrës*"- subjekti A.K.U.K. në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD STAR" sh.p.k. dhe projektin për segmente të tjera shtesë.
2. Punimet e kryerjes së sondazheve arkeologjike dhe zbatimit të segmente të tjera shtesë, të realizohen në vijim të akt-marrëveshjes së lidhur më parë për projektin "*Linja e Optimizimit të Ujësllësit, Durrës*"- subjekti A.K.U.K.
3. Raporti i rezultateve arkeologjike të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori A.K.U.K. si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al